

REPubLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

PROCES - VERBAL

"Mbi marrjen e modeleve eksperimentale të zerit të shtetasit Geron Xhafaj"

Në Tiranë, sot me datë 15.05.2018, ora 14:15.

Unë Grabon Vrioni Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 191 të K.Proc.Penale, sipas detyres së deleguar nga prokurori Genci Qana mbaj këtë proces verbal për marrjen e modeleve eksperimentale të zerit të shtetasit Geron Xhafaj. Marrja e modeleve të zerit bëhet në prezencë të ekspertit kriminalist Dritan Zoto.

Marrja e modeleve eksperimentale bëhet në ambientet e zyrës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe realizohet nepermjet një aparati dixhital rregjistrimi zeri, i markes "OLYMPUS", në përdorim të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, i identifikuar me numer të përdorimit vetjak 6150.

Fillimisht u ftua shtetasi Agron Xhafaj dhe për t'iu lexuar iu dha pjesë nga libri "Komente (dhe praktike) për procedurën penale" me autor Gentian Trenova, duke filluar nga faqja 147 (kapitulli nr. 8). Ky lexim zgjati 09 minuta e 53 sekonda.

Me pas u ky shtetas u ftua të lexojë shprehje që i atribuohen shtetasit të quajtur "Agron", në rregjistrimin e transmetuar nga disa stacione televizive në datë 14.05.2018. Gjate kësaj bisede u nderhy nga ana jone dhe me pyetje duke iu pershtatur bisedave sipas rregjistrimit të transmetuar, bisede e cila 3 minuta e 16 sekonda.

Me pas u zhvillua një tjetër rregjistrim me një bisede ku u improvizuan shprehje të njëjta apo të përafërta me ato që iu atribuohen personit me emrin "Agron", në rregjistrim.

Kjo bisede e rregjistruar zgjati 01 minute e 09 sekonda.

Në përfundim i gjithë materiali i rregjistruar u transportua në formë elektronike nga aparati rregjistruar në kompjuterin e zyrës së markes "DELL" dhe me pas u rregjistrua në një CD të markes "Verbatim".

Proces verbali filloi në orën 14:15 dhe përfundoi në orën 14:52.

Proces verbali mbasi lexohet gjendet i rregullt dhe firmoset pa verjetje nga të pranishmit në këtë veprim.

Te pranishem

GERON XHAFAJ

OFICERI I POLICISË GJYQËSORE

Grabon VRIONI

EKSPERTI KRIMINALSIT

DRTAN ZOTO

